



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:181089

Datë: 18.10.2024

Numri i dokumentit: 06317877

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku, me praktikantin Blerton Sejdiu, në çështjen penale ndaj të pandehurit E.G, nga Ferizaj rruga "N.H", për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së), sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.923/2024 të datës 02.08.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, i cili është mbajtur më datë 17.10.2024, në të cilin morën pjesë prokurorja e shtetit Mimoza Sylja Hyseni prokurore në Prokurorinë Themelore në Ferizaj dhe i pandehuri E.G me mbrojtësin e tij me autorizim av. Hysen Rrahmani, pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit E.G, më datë 17.10.2024, mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 18.10.2024, përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

E.G, nga i ati F.. dhe e ëma H... e gjinisë K...., i lindur më datë në F..., me vendbanim në rrugën "N.H" në F..., me numër personal, ka të kryer gjashtë klasë të shkollës fillore, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 30 mars 2024, rreth orës 21:30, në Ferizaj, rr. “U...”, pa autorizim ka poseduar substancë narkotike, në atë mënyrë që pasi është ndalur për kontroll nga zyrtarët policor, kishte hedhur në tokë një qese me substancë narkotike dhe një cigare të djegur të llojit “Marihuanë”, në peshë të përgjithshme prej 1.07 gram, të cilat zyrtarët policor i gjejnë dhe i konfiskojnë.

- Me këtë ka kryer veprën penale veprën penale **Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge** nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4 , 7, 8, 17, 21, 38, 43, 69, 70, dhe 269 paragrafi 2 dhe 3 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 452 dhe 455 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), të pandehurin e:

G J Y K O N

- I. Dënim me gjobë në shumën prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguajë brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, të njëjtit në pajtim me nenin 43 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguara, i pandehuri do të vuajë 1 (një) ditë burgim.
- III. Në bazë të nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-s, **KONFISKOHET** substanca narkotike e sekuestruar e llojit “Marihuanë” me peshë 1.07 gram.
- IV. Obligohet i pandehuri në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të dhunës shumën prej 20 (njëzet) euro, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm më datë 02.08.2024, ka ngritur

aktakuzën PP.II.nr.923/2024, kundër të pandehurit E.G për shkak të veprës penale Posedimi i paaautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së.

Me datë 17.10.2024, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Mimoza Sylja Sylja Hyseni prokurore në Prokurorinë Themelore në Ferizaj dhe i pandehuri E.G me mbrojtësin e tij me autorizim av. Hysen Rrahmani.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 paragrafi 2 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësinë nga ana e të pandehurit.

2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore të cilat kërkohen me nenin 242 paragrafi 2 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve të cilat ishin prezentë.

Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit dhe i njëjti nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë. Pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raporti i ekspertimit me numër AKF/2024-2347/24-2241 i datës 26.07.2024, Deklarata e të pandehurit E.G e dhënë në Prokurorinë Themelore në Ferizaj me datë 09.07.2024 dhe në Stacionin Policor në Ferizaj me datë 30.03.2024, Deklarata e dëshmitarit F.M e dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj me datë 30.03.2024, Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 30.03.2024, Zinxhir i ruajtjes së provave i datës 30.03.2024 si dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë, po ashtu me rastin e pranimi të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri E.G, ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit ti shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro, të cilin dënim i pandehuri është e obliguar ta paguajë brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë: pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, faktin se i njëjti është përdorur për veprën penale që e ka kryer dhe është hera e parë që kryen veprën penale, premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, moshën e re të pandehurit, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti.

Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së e që konsistojnë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5. Vendimi lidhur me konfiskimin e substancës narkotike

Neni 269 paragrafi 3 i KPRK-së përcakton shprehimisht se: “*Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen*”. Andaj, duke u bazuar në këtë dispozitiv ligjorë u vendos si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale gjykata duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që ta detyrojë të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20 (njëzet) Euro.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
2024:216900, me datë 18.10.2024

Praktikanti,
Blerton Sejdiu

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë.